



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot. No. 261/22 - 02/10
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg. 174
Data/Datum/Date: 23 - 09 - 2022 DITA - DNEV - DÍA - DATA - DATA - TARİH



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 23.09.2022
Vendimi nr. 36/22

Duke u bazuar në nenet 28, 29, 34, 35 dhe nenin 54, paragrafi 2.3 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas kërkesës së operatorit ekonomik ndërmarrja IFJB Paysera Kosova Shpk, kundër ndërmarrjes IPKO Telecommunications LL.C, me pretendimin për keqpërdorim të Pozitës Dominuese, në mbledhjen e mbajtur me datën 23.09.2022, merr këtë:

KONKLUSION

I. Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant Autoriteti konstaton se nuk argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjes IPKO Telecommunications L.L.C.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 26.11.2021 ka pranuar kërkeshën me nr. prot. 304/21-H, përmes z. Bashkim Zeqiri, përfaqësuesit i IFJB Paysera Kosova (*tutje*: Paysera). Pretendimet e ankuesit janë se i njëjti ka tentuar disa herë të bisedojë me zyrtarët e kompanisë IPKO Telecommunications LL.C (*tutje*: IPKO), e cila ka licencë publike për ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit, që të ofrojë mundësinë për klientët e saj që nëpërmes Paysera të kryejnë pagesat e produkteve të telekomunikimit që ofron IPKO. Aktualisht qytetarët të cilët, kanë llogari në Paysera obligohen të paguajnë tarifa shtesë për këto shërbime. Sipas përfaqësuesit ky trajtim i pabarabartë i qytetarëve, paraqet një shkelje të rëndë nga IPKO ngase shërbimet e telefonisë mobile dhe shitjet së impulseve të telefonisë nga IPKO janë monopol në treg dhe obligojnë qytetarin të paguajë këto tarifa të panevojshme që Paysera i ofron falas.

Sipas përfaqësuesit të IFJB Paysera Kosova aktualisht IPKO ofron mundësinë e pagesave për të gjitha bankat e Kosovës, ky diskriminim ndodh vetëm për qytetarët (*klientë që shfrytëzojnë*, *Paysera*). Kemi tentuar shumë herë të qartësojmë raportin se, shërbimi që ofron IPKO sipas licencës publike ka edhe përgjegjësi publike, mirëpo nuk kemi arritur të sigurojmë arsyen e kësaj qasjeje.

Autoriteti ta shqyrtojë faktin se, a paraqet IPKO pozitë monopoli në tregun e komunikimit mobil në Kosovë dhe faktin e trajtimit jo të barabartë për qytetarët (*klientët që përdorin Paysera*). Ne kemi ankesa të vazhdueshme nga klientët që kërkojnë ta dinë arsyen, se pse nuk minden të realizojnë pagesat e tyre për IPKO pa komisione, por duhet të paguajnë tarifa shtesë për klientët e Paysera me kompani apo institucion që kanë licenca për shërbime publike.

Ky vendim nga IPKO na obligon si IFJB të kalojmë përmes Bankave të Kosovës, duke mos na ofruar trajtim të barabartë dhe qasje për të shërbyer klientët tanë në mënyrën siç kërkojnë ata.

Tregu relevant

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit - ofrimi i shërbimeve për pagesa elektronike dhe lëshimin e parave elektronike.

Aktivitetet e zhvilluara në shqyrtimin e hetimit paraprak të tregut përkatës dhe korniza ligjore

1. Shqyrtimi i kërkesës se datës 26.11.2021, nr. prot. 304/21-H;
2. Janë analizuar Pasqyrat e Përgjithshme të Tregut të Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës për vitin 2021 dhe TM1/TM2 2022 (ARKEP);
3. Takim me përfaqësuesit e ndërmarrjes IPKO Telecommunications LL.C;
4. Takim me përfaqësuesin e ndërmarrjes IFJB Paysera Kosova Shpk;
5. Është konsultuar Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25);
6. Është konsultuar Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
7. Është konsultuar Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
8. Është konsultuar Ligji Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare.

1. Ndërmarrja IFJB Paysera Kosova Shpk

- a) Ndërmarrja IFJB Paysera Kosova Shpk është një institucion i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, i parave elektronike, i cili ka të drejtë të kryejë aktivitete në lidhje me lëshimin e parave elektronike, ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe këmbimin valutor në Republikën e Kosovës. Institucioni inspektohet dhe kontrollohet periodikisht nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- b) Paratë e mbajtura në llogaritë e Paysera Kosova mbrohen nga nen 9 i Rregullores për kapital rregulator dhe ruajtje të fondeve të IFJB-Institucion finanziar jo-bankar, mbahen vetëm në llogari të veçanta bankare ekskluzivisht për mbajtjen e fondeve të klientëve, nuk

përdoren për nevojat e kompanisë, hua, apo investime, dhe nuk mund t'i nënshtronen rikuperimit të borxheve të institucionit të parave elektronike.

2. Ndërmarrja IPKO Telecommunications LL.C

IPKO Telecommunications LL.C, është kompani e telekomunikacionit, e themeluar në vitin 1999. Është ofruesi i parë i internetit në Kosovë, që ofron shërbimeve të integruara si dhe përmbajtje në komunikimet mobile, telefoninë fiksë, TV kabllor digital dhe shërbimet e internetit. Kjo kompani ofron internet mobil – rrjetet 3G dhe 4G në Kosovë.

3. Analiza e Konkurrencës

- a) Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar ndërmarrjen IPKO për shkak të shqetësimeve të ngritura nga ndërmarrja Paysera lidhur me pretendimin për keqpërdorim të pozitës dominuese, sipas kërkesës ndërmarrja IPKO nuk është duke hapur llogari në platformën Paysera që klientët të kryejnë pagesat e shërbimeve për ndërmarrjen IPKO.
- b) Bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës Autoriteti ka siguruar të dhënat nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), sipas të dhënavë ndërmarrja IPKO ka këtë strukturë të tregut: *për vitin 2021 ka pozitë dominuese sipas të hyrave 43%, ndërsa për periudhën TM1/TM2 të vitit 2022, ka 40%.*
- c) Refuzimi i marrëveshjes nga ndërmarrja IPKO nuk e eliminon konkurrencën në treg, në rastin konkret, Autoriteti konsideron se ndërmarrja IPKO në nivelin e njëjtë nuk e ka konkurrent ndërmarrjen Paysera, refuzimi për marrëveshje nuk mund të arsyetohet, vetëm në rastet kur shërbimet janë të domosdoshme pér të kryer aktivitet ekonomik pér ndërmarrjet tjera në treg, pér aq sa nuk ka zëvendësues aktual ose potencialë pér këtë shërbim. Prandaj, jo çdo refuzim pér t'u marrë me marrëveshje konsiderohet si abuzim.
- d) Ndërmarrja IPKO duhet t'i vendl ofrumin e shërbimeve vetëm nëse produkti është i domosdoshëm pér ndërmarrjen Paysera, pér të konkurruar në tregun e rrjedhës së poshtme, e cila nuk ka arsy e objektive pér refuzimin e marrëveshjes, në rastin konkret Autoriteti konstaton se ndërmarrja Paysera nuk vepron në rrjedhën e poshtme të tregut, sipas arsyetimive të ofruara nga ndërmarrja IPKO nuk ka ofruar marrëveshje pér shkak të krijimit të shpenzimeve shtesë pér të, dhe e njëjta aktualisht ka marrëveshje pér pagesa elektronike vetëm me një Bankë e cila vepron në Kosovë si dhe përmes dy platformave vetanake ku përdoruesi i shërbimeve te IPKO-së mund të bëjë pagesa online në *My IPKO* dhe *Shop IPKO* në web faqe.
- e) Autoriteti, konsideron se produkti/shërbimi, është i domosdoshëm kur nuk ekziston alternativë dhe ka pengesa të ndryshme (*teknike, ligjore, ekonomike*) të cilat e bëjnë të pamundur ose në mënyrë të paarsyeshme të vështirë krijimin e një produkti/shërbimi. Produkti/shërbimi është i domosdoshëm, kur konkurrentët ndërmarrja dominuese i përjashton, si rezultat i refuzimit, pengohen të sjellin mallra ose shërbime novatorë në treg.
- f) Autoriteti vlerëson se: ekziston një parim i përgjithshëm i lirisë pér të zgjedhur partnerët ekonomikë me të cilët ndërmarrjet janë të gatshme të merren dhe të disponojnë lirisht pronën e saj. Ky parim zbatohet gjithashtu pér ndërmarrjet me pozitë dominuese, vetëm në

rrethana të jashtëzakonshme mund të vendoset një detyrë për të kryer, marrëveshje. Me fjalë të tjera, një refuzim për marrëveshje nuk është i paligjshëm, si i tillë dhe mund të shkelë ligjin e konkurrencës vetëm kur kufizon konkurrencën pa ndonjë arsy objektive.

- g) Tregu për ofrimin e shërbimeve ishte transparent, konkurenca në këtë treg është e përqendruar në disa kompani, klientët kanë pas dhe kanë mundësi të zgjedhin që të shërbehen, në bankat dhe institucione tjera financiare jo bankare.

II. Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

KOMISIONI

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Neime Binaku Isufi

Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare



Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- *Paraqitësi i kërkësës*
- *Arkiva*